



RI-SHPALLJA PËR VLERËSIMIN E KOSTOS SË RINDËRTIMIT PËR DY OBJEKTE

Ndërmarrja Shoqërore “Metaliku – Fabrika e Enëve” Gjakovë , e cila është në Administrim të Drejtpërdrejt të AKP-së,

RI-SHPALLË FTESË PËR OFERTË

Ftohen operatorët ekonomik që të ofertojnë për vlerësimin e kostos së rindërtimit të objektit të ish drejtorisë në sipërfaqe prej 822m² (P + 1) dhe objektin në sipërfaqe prej 509m², pronë e Nsh Metaliku Ena Gjakovë

I. KUSHTET / KRITERET TEKNIKE TË OFERTIMIT PËR OPERATORET E KONOMIK – VLERËSUESIT E PAVARUR Ofertuesit duhet te ofrojnë:

1. Certifikatën /Numrit Unik Identifikues të biznesit / ose numrin fiskal të vlerësuesit të pavarur;
2. Kompania / Vlerësuesi i pavarur duhet të ketë licence për kryerjen e angazhimeve të tilla të vlerësimit dhe të ketë staf profesional (inxhinieri të ndërtimtarisë apo të lëmive të ngjashme që kanë përvojë në pune të ngjashme);
3. Kompania duhet të ofroj dëshmi për kryerjen e punëve të ngjashme – së paku dy referenca për kryerjen e punëve të ngjashme të vlerësimit;
4. Duhet të paraqes Çmimin e ofruar për vlerësimin e kostos së ndërtimit për dy objektet;
5. Afati për kryerjen e vlerësimit të kostos së ri ndërtimit dhe dorëzimit të raportit mbi koston e rindërtimit të objekteve 15 ditë pas nënshkrimit të kontratës;
5. Oferta duhet të jetë shumë e qartë dhe të përfshijë të gjitha detajet e kërkuara, e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik apo vlerësuesi i pavarur.

II. VIZITA NË NDËRMARRJE

Palët e interesuara mund të vizitojnë ndërmarrjen prej datës 05 korrik 2023 deri me 11 korrik 2023 për tu informuar në detaje në lidhje me gjendjen dhe lokacionin për vlerësimin e kostos për rindërtimin e dy objekteve.

Për sigurimin e informatave rreth objektit në sipërfaqe prej 822m² (P+1) dhe objektit në sipërfaqe prej 509m² e kontaktoni koordinatoren e NSH - Fabrika Metaliku Ena Gjakovë - Florim Maliqi, në nr. tel 044/734-966.

III. KRITERET PER DHENJEN E KONTRATES:

1. Çmimi më i ulët për vlerësimin e kostos së rindërtimit për të dy objektet ;
2. Garancioni bankar në lartësinë e kontratës dhe të mbulojë kohëzgjatjen e kontratës;

IV. AFATI KOHOR DHE VENDI PËR DOREZIMIN E OFERTAVE

Ofertat finale të cilat duhet të jenë në zarf të mbyllur, duhet të dorëzohen më datën 11 Korrik 2023 nga ora 10⁰⁰ deri në orën 11⁰⁰ në adresën e mëposhtme:

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. Dritan Hoxha, nr. 55, Lakrishtë - Prishtinë.

Ofertat do të hapen me datën 11 korrik 2023 në ora 11¹⁵

- V. Përfaqësuesit legjitim të ofertuesve, mund të marrin pjesë me rastin e hapjes së ofertave.